



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:092862

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05766793

P.nr.337/2021

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja e vetme gjykuese Ilda Cucović Sahatçiu, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gylaj Nepola, në çështjen penale kundër të pandehurit Xh.G nga fsh. Q, Komuna Pejë, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprë penale,, Vjedhja e shërbimeve’’ nga neni 314 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.821/2021 të datës 14.05.2021, në bazë të nenit 229 par.5, 357 të KPPRK-së dhe nenit 12 dhe 15 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, jashtë shqyrtimit, me datë 31.05.2024, bie këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET** marrëveshja për ndërmjetësim me shenjë ND.nr.833/24 e lidhur me datë 28.05.2024 në mes të pandehurit Xh.G nga fsh. Q, Komuna Pejë (A) me nr. personal dhe palës së dëmtuar KEDS-it të cilin e përfaqëson Arbon Morina.
- II. HEDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.821/21 të datës 14.05.2021.
- III. PUSHOHET** procedura penale ndaj të pandehurit Xh.G, për veprë penale,, Vjedhja e shërbimeve’’ nga neni 314 par.1 të KPRK-së , për shkak se i pandehurit dhe i dëmtuari kanë arritur marrëveshje për ndërmjetësim.

IV. Shpenzimet e procedurës penale i bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzë nën shenjën PP/II.nr.821/21 të datës 14.05.2021, ndaj të pandehurit Xh.G, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se i njëjti ka kryer veprë penale,, Vjedhja e shërbimeve’’ nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

Në këtë çështje penale, kjo gjykatë me datë 28.05.2024, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën seancë, pas leximit të aktakuzës, gjykata sipas detyrës zyrtare konform dispozitave të Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim dhe Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale ka informuar palët se lënda penale mund të referohet në procedurën e ndërmjetësimit me pëlqimin e të pandehurit, të dëmtuarës dhe të Prokurorit të Shtetit, me ç ‘rast palët njëzëri janë deklaruar se pajtohen që çështja penale të referohet në procedurën e ndërmjetësimit, me qëllim të arritjes së marrëveshjes eventuale.

Pas pëlqimit të palëve për zgjidhjen e kësaj çështje penale në procedurën e ndërmjetësimit, gjyqtarja e çështjes e ka ndërprerë seancën dhe me datë 28.05.2024, ka marr vendimin për ta dërguar lëndën pranë koordinatorit për ndërmjetësim të kësaj gjykate në mënyrë që ta procedoj lëndën në procedurë të ndërmjetësimit.

Me datë 28.05.2024, në Qendrën e Ndërmjetësimit në Pejë, është lidhur marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar nga ndërmjetësuesi Kaltrina Rexhepi, ndërmjet të pandehurit Xh.G dhe të dëmtuarit KEDS-it me përfaqësues Arbon Morina.

Sipas marrëveshjes së arritur ndërmjet të pandehurit dhe të dëmtuarës palët kanë deklaruar se marrëveshjen e lidhin në vullnet të plotë dhe pa shtytje nga askush. Njëkohësisht të pandehurit i shprehën keqardhje të dëmtuarit për rastin e ndodhur dhe njëkohësisht i kërkon falje të dëmtuarit- me ç ‘rast i dëmtuari e pranojë kërkim faljen. Pala (B) respektivisht i pandehuri u pajtua që pagesën e dëmit-rikthimit të humbur në vlerë prej 141.00 euro do t’ia paguaj palës (A) – të dëmtuarit , me tri (3) këste duke filluar nga data 03.06.2024.

Palët pa ndonjë kërcënim dhe me vet dëshirë kanë shprehur gatishmëri që kjo çështje të zgjidhet me marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit dhe nuk i kontestojnë asnjë nga pikat e lartpërmendura.

Qendra e Ndërmjetësimit me datë 28.05.2024, me numër të lëndës në ndërmjetësim Nd.nr.833/24 ka lidhur marrëveshjen e palëve të lartpërmendura për zgjidhjen e ndërmjetësuar.

Andaj, gjykata duke vepruar sipas dispozitave të nenit nenit 229 paragrafi 5 të KPPRK-së dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, e aprovoi këtë marrëveshje pasi që e njëjta u vlerësua se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve dhe është në pajtim me dispozitat e KPPRK-së dhe me Ligjin për Ndërmjetësim, ku kjo marrëveshje do ta **ketë fuqinë e titullit ekzekutiv**.

Në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPPRK-së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Gjykata duke u bazuar në provat si më lartë dhe në bazë të nenit 229 par.5, 357 par.1 nën par. 1.3, nenit 453 të KPPRK-së dhe nenit 12 dhe 15 par.1 të Ligjit për ndërmjetësim, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË

Departamenti i Përgjithshëm

Divizioni Penal

P.nr.337/2021, me datë 31.05.2024

Bashkëpunëtorja profesionale

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Gylaj Nepola

Ilda Cucović Sahatçiu

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese, në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, pranë Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.